

NGA NE



PËR NE

ELEMENTET E DEMOKRACISË

LEOTRIM (13), DIELLZA (15), MERITA (12), DIOR (12), ERMAL (14)



Demokracia ka edhe shumë elemente të tjera, përpos këtyre që ne i kemi cekur këtu. Por, në peshore theks të veçantë i kemi dhënë barazisë dhe lirisë, sepse kur je i lirë edhe i barabartë me të tjerët, atëherë pa dyshim që je pjesë e demokracisë

Demokracia ka zanafillë shumë të lashtë, e rëndësia e saj tek vendet dhe njerëzit e këtyre vendeve veç sa vjen e shtohet

Sot në këtë ditë me diell patëm mundësinë t'i diskutojmë disa gjëra që na ndriçojnë jetën, pothuajse njëjtë si Dielli. Një ndër temat që diskutuam ishte demokracia, e cila u shfaq në Athinë në vitin 507 para erës sonë.

Për të kuptuar më mirë rëndësinë e këtij sistemi, sepse vetë demokracia është sistem i qeverisjes, ne në grupin tonë u ndamë në dy sisteme. Sistemi i demokracisë, i cili u përfaqësua nga shokët Diori, Ermali, si dhe edukatorja Duresa. Ndërsa, sistemi i diktaturës u përfaqësua nga unë Merita, Leotrimi, si dhe Diellza. Ajo çfarë ne dëshironim të tregojmë me anë të kësaj ndarjeje, ishte rëndësia që demokracia e ka në jetën tonë. Pasi që, gjërat i kuptojmë dhe i vlerësojmë më mirë, atëherë kur e shohim që dikujt tjetër i mungojnë ato. Grupi i demokracisë na tregonte më shumë për rëndësinë e secilit qytetar dhe që secili prej tyre i gëzon të drejtat e barabarta në këtë sistem. Ata, po ashtu na treguan që nëse qytetarët janë të pakënaqur me ndonjë situatë, ata lehtë mund ta adresojnë atë. Gjë që për ne, grupin e diktaturës ishte e pamundur. Në sistemin diktatorial të grupit tonë, me apo pa dëshirën e qytetarëve, ne nuk e gëzojmë këtë të drejtë. Gjithashtu, ne



në këtë sistem barazinë për të cilën flisnin shumë grupi i sistemit të demokracisë, nuk e njihnim fare. Sepse unë nuk mund të trajtohem në të njëjtën mënyrë si të tjerët. Këtë ndarje e bëmë vetëm që edhe ju, të dashur demokratë të kuptoni se sa e rëndësishme është demokracia. Unë, moshatarja e juaj Merita, kisha përgjegjësinë e diktatores. T'iu them të drejtën, nuk u ndjeva mirë kur mendoja se ende në botë ka vende me sistem diktatorial. Por, në anën tjetër, isha shumë e lumtur kur shihja shokët e sistemit demokratik se sa të lumtur bashkëpunonin në mes vete. Krejt në fund edhe ne, grupi i diktaturës iu bashkangjitëm grupit të sistemit të demokracisë, sepse ashtu si shokët dhe shoqet tona, edhe ne jemi pjesë e demokracisë. Kjo ishte ndjenja më e mirë që përjetuam ndonjëherë, të genurit vetë demokracia.



Demokracia është gjithmonë më e mirë se diktatura

SHTËPIA JONË E DYTË

ARJETA (13), DRENI (14), ENES (14), LIRIDON (13), ARJANIT (10), ARNESA (14)



Ne jemi ata që e zgjedhim Kuvendin, e Kuvendi punon për ne

Çfarë do të ndodhte nëse ne nuk do të shkonim në shkollë? Kjo është pyetja, të cilën ia bëmë sot vetes. Ne gjithashtu mësuam se cili institucion i formon ligjet që janë aq të rëndësishme për ne

Këtë artikull dëshirojmë ta fillojmë duke iu treguar pak për Kuvendin e Kosovës. Ky institucion njihet ndryshe edhe si „shtëpia e dytë e popullit“. Në Kuvend punojnë 120 deputetë, të cilët janë që të gjithë kosovarë. Por, 100 deputetë janë shqiptarë, kurse 20 të tjerë janë nga komunitetet jo shumicë, të cilët jetojnë në Kosovë dhe janë pjesë e saj. Deputetët zgjedhen nga populli, më saktësisht nga qytetarët mbi moshën 18 vjeçare. E kur jemi këtu, ne dëshirojmë t'i ftojmë të gjithë qytetarët mbi këtë moshë të marrin pjesë në zgjedhje. Pasi që ne i zgjedhim deputetët, ata kanë për detyrë të punojnë për neve duke i përfaqësuar nevojat dhe interesat tona. Ky quhet funksioni përfaqësues i Kuvendit. Po ashtu, Kuvendi ka funksion legjislativ. Por, çfarë do të thotë kjo? Paramendojeni se si do të ishte sikur të mos

shkonim në shkollë. Ne nuk do të mund të lexonim libra, nuk do të mund të shkruanim letra dhe kjo do të thotë se ne do të kishim njohuri dhe dije. Si pasojë, ne nuk do të mund të punonim e as të përparonim. Pra, shkollimi është gjëja më e rëndësishme dhe më me vlerë për ne si qytetarë në demokraci. Për këtë, kanë menduar përfaqësuesit e popullit. Kuvendi ka miratuar një ligj të shkollimit, i cili thotë se për të gjithë qytetarët, shkollimi i ulët dhe i mesëm i lartë është i obliguar. Me këtë ligj, jeta jonë është përmirësuar. Por, jo vetëm. Jeta jonë rregullohet edhe përmes rregullave të shtëpisë, të shkollës apo edhe të komunikacionit. Njëra prej rregullave që ne kemi në shtëpi është mirëmbajtja e gjërave personale.

Në fund, kemi edhe funksionin kontrollues, që do të thotë se Kuvendi kontrollon punët e Qeverisë. Nga kjo që thamë, ne mësuam se Kuvendi është shtëpia e të gjithë neve, prandaj si për shtëpitë tona, ne duhet të kujdesemi të gjithë edhe për Kuvendin.




Pa ligje, jeta jonë do të ishte një rrëmuje




Gazetarët e mrekullueshëm të këtij artikulli


Lexues të dashur, në vijim të kësaj gazete, mund të shihni disa nga punimet, të cilat i kemi bërë vetë ne. Të gjitha punimet flasin për temat që i kemi diskutuar dhe lidhen drejtpërdrejt me jetët tona. Shpresojmë që të gjitha do t'iu pëlqejnë, ashtu siç na pëlqeu edhe neve gjithçka që përjetuam sot!



Nëna e të gjithë institucioneve në Kosovë



Paqja, ky nocion aq i dashur nga ne




Deputetët flasin në emrin tim dhe tuajin



Unë jam i lirë të flas



Pasaporta ime më thotë se unë jetoj në një vend demokratik



Gratë dhe burrat janë të barabartë në pjesëmarrje

TË DREJTAT TONA NË DEMOKRACI

ADHURIM (13), ARLINDA (15), BESNIK (13), LINDRIT (15), MIRJETA (13), PËRPARIM (11)

Ne jemi të lumtur që jetojmë në një vend demokratik. Nëse dëshironi ta dini arsyen se pse jemi kaq të lumtur, lexojeni artikullin më poshtë


Ne si fëmijë në demokraci kemi shumë të drejta dhe të gjithë jemi të barabartë. Të drejtat tona janë: e drejta e familjes, e drejta e shkollimit, e drejta e lojës, e drejta e strehimit, e drejta e emrit, etj.

Përveç të drejtave, ne duhet të jemi të përgjegjshëm për veprimet tona. Për shembull, ne kemi të drejtë të luajmë, mirëpo përgjegjësia kemi që të mos e teprojmë me lojëra. Ne kemi të drejtë të vijojmë mësimet në shkollë, mirëpo përgjegjësia jonë është që të shkojmë në shkollë dhe të mësojmë. Ne kemi të drejtë të shprehim mendimet tona lirshëm, por secili prej nesh duhet ta dëgjoj dhe të respektoj mendimin e tjetrit.

Pra, të jesh qytetar i përgjegjshëm në demokraci është shumë e rëndësishme.



„Grupi i Artë“



Vetëm të bashkuar shkojmë përpara



Ne jemi qytetarë aktiv



Të votosh është përgjegjësi dhe kënaqësi



Të kujdesemi për ambientin



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Kadri Zeka“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VI, VII, VIII & IX
Website: www.demos-ti.org Vendi: Desivojcë & Poliqçë